



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**  
**V E N D I M**

Nr. 184 dt.25.08.1994

**“VENDIM I KESHILLIT BASHKIAK PER URBANISTIKEN”**

Bazuar në vendimet e Këshillit Bashkiak dt.14.04.1994, materialit dhe detyrave të Kontrollit të Shtetit, materialit të Drejtorisë së Urbanistikës dhe diskutimeve në Këshillin Bashkia në mbledhjen e dt.25.08.1994, Këshilli Bashkiak

**VENDOSI**

1. Të raportohet mbi zbatimin e vendimit të K.Bashkiak dt.16.04.1993 (Ato pjesë të vendimit që rezultojnë të pakryera të bëhen pjesë të këtij vendimi).
2. Të paraqiten evidencat të sakta e të gjithë ndërtimeve provizore (kjoskë, garazhde, rulo) dhe të përhershme të ndërtuara deri më 30.08.1994.
  - 1.Sa prej tyre janë përfshirë në planin rregullues të qytetit.
  - 2.Sa prej tyre janë me vendim K.RR.T.
  - 3.Sa prej tyre janë me leje dhe sa pa leje Drejtorisë së Urbanistikës deri më 30.10.1994.

3. 1.Të gjitha lejet e dhëna pa firmën e Kryetarit të Bashkisë të rishqyrtohen, të paraqiten para K.RR.T. dhe Këshillit Bashkiak.

2.Për personat që kanë leje jashtë kompetencës së tyre të merren masa për shkelje ligji.

3.Për objektet e ndërtuara pa leje në kundërshtim me planin rregullues të qytetit të merren masat e përcaktuara me ligj.

4. Për kërkesat urbanistike që kanë probleme sociale, detyrimisht duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak. Po ashtu rastet me më shumë se 1 kërkesë me një objekt të caktuar, përzgjedhja dhe miratimi i tyre të bëhet në Këshillin Bashkiak. Ndërsa pronarët e trojeve që duhet të ndërtojnë në truallin e tyre, leja e ndërtimit do të jepet nga K.RR.T.

5. Drejtoria Urbanistikës të hartojë dhe projektojë planin rregullues të qytetit.

1.Në veçanti për ndërtimet provizore të miratohet plani me njolla vendosje dhe bashkë me kërkesat të paraqitet në Këshillin Bashkiak për aprovim. Të përcaktohet çfarë do të konsiderohet kjoskë, lokal....

2.Të kryhen studime për ndërtimin e Tualeteve Publike, nevojat dhe mundësitë e ndërtimit të tyre. Deri më 30 Nëntor.

6. Për objektet e ndërtuara me ose pa leje që nuk bien në kundërshtim me këtë plan rregullues të paraqitet materiali për miratim në K.RR.T. dhe Këshillin Bashkiak. Për ndërtimet të veprohet si në pikën.3”c” .

7. Të bëhet verifikimi i të gjitha ndryshimeve në katet e para të ndërtesave të banimit.

1. Të bllokohen ato ambiente ku ndryshimet e bëra rrezikojnë godinën nga pikpamja teknike.

2. Për ambientet e tjera të paraqitet materiali në K.RR.T. dhe Këshillin Bashkiak. Deri më 30 Tetor 1994.

8. Për ndërtimet me shkelje të përmasave të caktuar në leje, të vendoset gjoba dhe qiraja në vartësi të gjëndjes reale (pasi ndërtimi të jetë miratuar nga K.RR.T. dhe Këshilli Bashkiak).

9. Drejtoria Urbanistikës, Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli i Bashkisë t'u kërkojë Organeve të Policisë Ndërtimore, Policisë së Rendit, Zyrës së Taksë – Tatimeve bashkërendim, dhe zbatimin e ligjit për ndërtimet pa leje. Deri më 10 Tetor 1994.

1. Për ndërtimet pa leje në proces të veprohet nga Policia Ndërtimore dhe e Rendit pa vendim të K.RR.T. – ligji e parashikon si shkelje.

2. Zyra Taksë – Tatimeve të vjelë të gjitha taksat dhe tatimet dhe ajo të bëjë shpërndarjen e taksave për qëllime të ndryshme.

3. Të përcaktohet dhe zbatohet mënyra e vjeljes së gjobave.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**